



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.07.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rustemi, DSHPM SH
13. Bekim Shabani, DP
14. Safet Krasniqi, auditor i mbrëmshëm
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e KPF-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023.
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2022.
4. Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2022, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.
5. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "PASTRIMI" SH.A.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Ganimete Qeriqi, tha se çështjen që do ta potencoj para jush është, shkelja e të drejtave të punëtorëve që punojnë në ndërrimin e natës dhe fundjavave. Pse këtyre punëtorëve nuk ju paguhet ndërrimi i natës sipas ligjit të pagave dhe kontratës kolektive ma parë që ka qenë. Punëtorët kanë bërë kërkesë në drejtori qysh e donë reni, as që kanë marrë përgjigjeje. Pse ky injorim? Pse duhet gjithmonë këta punëtorë me ju realizuar të drejtat e veta përmes gjykatave e përmbaruesve. Pse me ju bërë kjo torture psikikë. Ndërroni këta punëtorë nga ndërrimi i natës.

Egzona Bytyqi, tha se i kam disa çështje për t'i ngritur, e para ne kemi bërë si grup i PDK-së, një vizitë në qendrën mësimore në Janjevë ku aty u mahnita me aktivitetet që zhvillohet aty, nga gratë dhe fëmijët. Unë kërkoj nga DKRS-ja, që këtë qendër me mbështet dhe me ju gjet një lokal, dhe të ju subvencionet qiraja e ati lokali. Kërkoj nga ana e organeve të sigurisë që ti hetojnë patrullat në këtë kohe e sidomos në parkingjet e qytetit. Tjetra, fshatrat e regjionit të Magures po kanë problem me rrjetin e telefonisë vala dhe ipko a kishe pas mundësi ju si komune me bo diçka? Pasi jemi në ditët e Mërgatës, e kam një propozim që t'i hapim dyert e kuvendit dhe ti presim mërgimtarët dhe t'i presim ide, sugjerime apo edhe investime nga mërgimtarët tonë. Tjetra ditëve të fundit më ka bre shume fakti se këto investime publike kanë marrë përmasa të një fenomeni shumë të shëmtuar pasi që janë dëmtuar shumë, pasi qytetarët duhet të kenë shumë kujdese ta ruajnë hapësirën publike, tjetra me intereson ta di a është pezulluar vendimi nga MAPL-ja që ka të beje me vendosjen e memorialit të UÇK-së në Qylagë? Dua ta di që cili ka qenë argumenti procedural i vendimi që nuk është pranuar.

Arsim Jashari, tha se kam disa çështje për t'i ngritur, çështje dhe një propozim. E parë, a ka mundësi që nëpër disa fshatra ku ndalojnë autobusët që të ketë një stacion ku ndalet autobusi jo në çdo vende, sepse po behën kolona të automjeteve pasi kjo gjë është edhe rrezik për qytetarët. Nga drejtorja e shërbimeve publike të caktohet ndalja e autobusit në 3 lokacione të fshatit në hyrje, në mes dhe në fund, çështja e dytë është mirë që kur të investohet në lokalitetet tona pasi që i kemi kryetarët e fshatrave në çdo vend të koordinohen me këshillin e fshatrave edhe bëhet puna ma mire, pasi që në fshatin Banullë kemi ndërtuar një sallë shumë e mire po që nuk është njoftuar as kryetari as këshilli i fshatit. Kish qenë mirë në të ardhmen të njoftohen. Kërkesa ime tjetër është që në fshatin Konjuh që e lidh me magjistralen në fshat nuk ka ndriçim as tretuar ku është mjaft e rrezikshme për natën ata kanë pyet për ekzekutivin që a kanë diçka me vendos në të ardhmen. Kërkesa e katërt është nga fshati Kraishtë që rrugët janë shtruar shumë mirë po çka po ndodh vjen e bënë kërkesën me ja shtrua rrugën po pasi që po përfundon rruga nga ekzekutivi punën ai zotëria del dhe thotë kjo rrugë është pronë private, pasi dhe kryetari është jurist me profesion e din shume mire, se nga momenti që ai e bën kërkesën që ti shtrohet ajo rrugë ma ajo nuk është pronë e tij, pasi që e tij mundet me qenë në aspekt juridik po për ta shfrytëzuar nuk mundet të ja ndaloj askujt. Tjetër rast e kemi edhe në fshatin Magurë ku është ndaluar trotuari. Çështja tjetër kemi në fshatin Smallushë te familja Bytyqi ku 15 familje kanë mbet pa

ndriçim publik ku kanë pyetur a keni në plan afat shkurtër apo afat gjatë që te vazhdoj ai ndriçim pasi që ato familjen kanë mbet të diskriminuara. Kam një çështje tjetër pasi që drejtori i shëndetësisë nuk qenka, po këtë pyetje po ja bëjë kryetarit. Konkursi i fundit që është bërë a mundeni të me tregoni pse nuk është caktuar afati ligjore, pasi që afati është 15 dite intervista me shkrim dhe intervista me goje. Po cila është arsyeja e kriterit 2 vite provoj pune, pasi që për fat të mire në kuvend kemi 11 persona që punojnë në shëndetësi, me momentin që e kryen fakultetin dhe e merr praktiken 6 muaj licencën në afat ti je i aftë për të punuar në këtë lëmi. Një person që ka licencën shteti ja mundëson që ai person të punojë. E kam një propozim lidhur me turnirë nëpër fshatra sepse i kemi 63 fshatra ku ne çdo fshat duhet shkuar për ti uruar dhe për te përcjell natën finale. Por dëshmoret janë të gjithë njësoj dhe çdo gjë që ka vlerë në vendin tonë duhet te mbrohet dhe te vlerësohet nga institucionet jo nga individit, janë dy turnirët që e kanë marr emrin nga Xhavit Kozhani dhe Ismaj Luma që e kanë marre një epitet të madh, unë jam i pajtimt që ta kemi vetëm një turnir madhështor që të rritet vlera e çmimit të parë dhe të dytë, nën patronatin e nivelit komunal te fillojmë një muaj para dhe ditën e dëshmoreve të jetë finalja është mire që të analizohet ky propozim.

Lumturie Bytyqi Hasani, tha se diasporën e kemi ende këtu dhe kemi ngritje të larta të temperaturave, është mirë të bëhet dezinfektimi i hapësirave publike në këtë rast emergjenca sepse ka shumë ankesa të qytetarëve për inekte të ndryshme që kanë vërshuar qytetin tonë. Pyetja tjetër shkon për drejtorin përkatës për shitësit ambulantiv në shesh; a kanë te drejt siç e bëjnë aty unë e kam parasysh se ata persona kanë dal për të fituar bukën e gojës po shteti ka rregulla dhe duhet zbatuar ato. Unë isha pjesë e organizimit të festës së diasporës që filloj dhe përkundër numrit të madh të qytetarëve unë nuk pash asnjë polic të qëndronte në shesh për arsye sigurie të qytetarëve. Dhe dua të përgëzoj stafin e emergjencës që kanë qëndruar aty janë për çdo lëvdatë. Qështja tjetër është te këndi i lojërave në fshatin Sllovi sepse ai kënd nuk është mirëmbajt tash e sa kohë fëmijën e kanë të pamundur që t'i shfrytëzojnë këto lojëra prandaj e kam këtë kërkesë që të bëhet largimi i barishteve në atë kënd.

Lulzim Rustemi tha se kam disa pyetje: pyetja e parë për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit se çka po behet me qendrën informative në sheshin "Adem Jashari" mendoj që kjo qendër duhet te hapët në sezonin e vërës për arsye që qytetarët e mërgatës të ofrohen fletëpalosje që të vizitohet Komuna e Lipjanit sepse mërgata jonë i shpenzojnë një pjesë të hollave në Prizeren, Rugovë dhe vende të ndryshme sepse pjesa më e madhe nuk i dinë vlerat dhe bukuritë natyrore të komunës sonë. E dyta për infrastrukturën një projekte për rregullimin e hapësirave publike në fshatin Poturovc ka ankesë prej qytetarëve që ky projekt ka mbetur në gjysmë është hapësirë gjelbëruese me dru dekorativ është lënë në gjysmë. Lusim drejtorin e infrastrukturës që ky projekt të përfundoj. Te shërbimet publike është shpërthimi i një kanalizimi në rrugën "Marie Shllaku" që po ndodh çdo ditë është një erë e keqe që po kundërmon që është edhe e dëmshme për qytetarët. Qështja tjetër ka të bëjë me DKA-në, a ka informatë lidhur me testet e arritshmërisë dhe ato të maturës ku nuk kemi asnjë rregullat dhe nuk e dimë se çka ka ndodhur me testin e atyre nxënësve. Po ashtu edhe

komiteti i arsimit edhe pse është themeluar nuk është që ka diskutuar për testet në fjalë. Kam një propozim që pronat që janë të lira të bujqësisë ti qesim në ankand publik.

Shahadije Dragaqina, tha se qeshtja e parë që duhet ta ngrisë ka të bëjë me gjendjen e ujit të pijes në fshatin Janjevë që është shumë e keqe ku ekzekutivi për tre mandate nuk ka mundur të gjej zgjidhje. Po ashtu problem me ujin e pijes kanë edhe banoret e qytetit të Lipjanit edhe disa fshatrave tjera. Problem tjetër në qytetin tone është edhe problemi me kanalizim që e përfshin edhe shumë fshatra të komunës tonë. Qeshtja tjetër janë mushkonjat që janë te shumta në qytetin tonë ku nuk është marr asnjë mas lidhur me dezinfektimin.

Besjana Sylaj, tha se unë e kam një kërkesë për ekzekutivin ku te bëhet dezinfektimi i mushkonjave në hapësirat publike të komunës sone po ashtu edhe nëpër fshatra sepse edhe ata po kanë problem me insekte dhe bartjen e sëmundjeve të ndryshme.

Ardit Cani, tha kam një kërkesë se bashku me banorët e fshatit Bainsë dhe kryesin e fshatit që te bëhet asfaltimi i rrugës që të dërgon te uji i nxehtë. Kërkesa e dytë të behet ndriçimi publik ne fshatin Bainsë dhe Resinovec si dhe zhavorrimi i tokës bujqësore që është kërkesë e bujqëve të kësaj ane.

Fadil Spahiu, tha se unë kam dy kërkesa dhe një pyetje për t'i ngritur: Kërkesa e parë është për Drejtorinë e Infrastrukturës; Banorët e një Lagjeje që lidhet me rrugën "11 Qershori" në fshatin Smallushë kanë bërë kërkesë që të asfaltohet rrugica e lagje së tyre, kërkesat me shkrim i kanë dërguar edhe tek Drejtoria e Infrastrukturës në baza individuale në emër të Zeqir, Remzi, Shefredin, Bedri, Ahmet dhe Izet Krasniqi, mirëpo me që rruga e kësaj lagjeje edhe pse ekziston me dhjetëra vite ende është pronë private banorët kanë shprehur gatishmëri për çfarë do lloj marrëveshje që është e nevojshme, si dhe kanë kërkuar që të emërtohet kjo rrugicë. Pra, kërkesa e tyre është që mos të mbetet rruga pa u asfaltuar për arsyeje të çështjes pronësore. Kërkesa e dytë është përsëri për Drejtorinë e Infrastrukturës nga banorët e katër lagjeve të fshatit Smallushë: Banorët e këtyre lagjeve kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit për asfaltimin e rrugicave të asfaltohet rruga që fillon nga shkolla e fshatit deri tek varrezat e këtyre lagjeve. Gjatësia e kësaj rruge është rreth 100 metra përkatësisht rreth 300 metra katror. Pyetja për ekzekutivin është bërë nga banorët e Lagjes "Anton Çeta" në Lipjan, kjo Lagje është mbrapa Xhamisë së Qytetit, pra banorët kanë bërë pyetje se a është arritur ndonjë marrëveshje me një pronar të një parcele që përshkon përgjatë kësaj hapësirë të rrugës, lidhur me asfaltimin e kësaj pjese të rrugës, sepse një pjesë e rrugës me gjatësi rreth 20 metra që dy vite ka mbetur e pa asfaltua për arsyeje pronësore.

Alban Salihu, tha se pari është mire që te pyetjet të bëhet një ndryshim pasi po ka diskutime dhe të paktën të shpërndahen pyetjet e jo të fokusohen vetëm te një grup. Kam disa pyetje a është bërë dezinfektimi i mushkonjave apo pritet të bëhet në ditët në vazhdim. Qështja e dytë ka të bëjë me kompaninë e mbeturinave të jetë më efikase në këto ditë pasi që shportat e mbeturinave po janë të stërngarkuara këto ditë. Dhe e fundit është mirë të ju bëhet një zgjidhje qenve endacak pasi që kohën e fundit ky fenomen është shpeshtuar.

Daut Azemi kryesues i kuvendit tha, që çështjen e renditjes ke të drejtë mundemi nga mbledhja e ardhshme të bëhet në proporcion në bazë të grupeve më të mëdha.

Armend Grajqefci, tha se kam disa kërkesa duke e ndërlidh edhe me Albanin që ka përdorë komuna e Prishtinës duke i bërë kërkesë kompanisë pastrimi që të pastrohen kontejnerët me ujë, Kurse një pyetje tjetër për drejtoratin e infrastrukturës që a është e mundur që të vendosim disa pengesa tek rruga që është duke u asfaltuar në Ribar të Madh rruga “Vebi Kozhani”. Tjetër kërkesë është që të bëhet ngjyrosja e muralit në sheshin e qytetit dhe i përgëzoj ekzekutivin për organizim e Mërgata Festë.

Imri Ahmeti Kryetari i Komunës tha se lejoni që të jap përgjigje për disa tema që vërtet ia vlen po nisem nga disa çështje që janë fenomene jo vetëm në komunën tonë çështja e dizinfektimit jo e dezinfektimit është një problem në tërë Kosovën është problematike para mekanizmi që duhet të përdoret nëse mendojmë me një logjik se si bëhet kjo punë në Kleqkë, Shalë, Krojmir nëse dini si praktikohet kjo punë unë do të kisha me pranua sepse nuk mundem t’i dallojmë familjet me familje s’mundëm me drona siç po thotë Arsimi, pasi që ka të drejt. Unë nuk marr shembuj nga askush jam autokton në vendime të mia dhe punoj sipas asaj që duhet të punohet e jo të kopjohet. Kemi provua shtigjet e ecjes ti kryem një dite dhe kemi provua me pa efektin jemi në proces me pa pasi që nuk kishim mjete buxhetore të mjaftueshme pasi që ju do të thoni që keni shpenzua mjetet për këtë punë që vërtet nuk ja vlen. Për qenat endacak do të filloj shumë shpjet për qytetin e Lipjanit jo për çdo fshat. Pengesat në rrugë do të ketë aty ku shihet e nevojshme e jo në çdo vend. Sa i përket shpronësimit të rrugëve ne do të shpronësoje vetëm aty ku janë të nevojshme dhe janë të parapare me harta zonale. Rrugët e arave janë të nevojshme por nuk do të kemi mundësi që ta bëjmë. Sa i përket ujësjellësit ne nuk e menaxhojmë atë, ato menaxhohen nga kompania regjionale e ujësjellësit, menaxhohet nga Qeveria, prandaj duhet ti adresoni problemet te qeveria. Ne nuk menaxhojmë as me kompanitë e telefonave apo te sistemeve kablllove. Testet e arritshmerisë do ti keni në raportin 6 mujor të kryetarit, që do të vijë në seancën e radhës. Edhe në Poturovc, Magaure, Lugaxhi, për hapësirat

publike i është shkëputur kontrata operatorit për shkak të mos kryerjes së punës si duhet. Për Mërgatën i kanë hap dyert të gjithë, dhe po mirëpritën nga të gjithë dhe ata e dinë se çka ka në Lipjan. Mirëmbajtja e këndit të lodrave e drejtë. Policia dhe emergjenca kanë qenë në Mërgata Festë. Shitësit ambulator e drejtë ne kemi marr verimet preventivë që mos të na pengojnë ne shesh dhe ata që nuk na kanë dëgjuar i kemi larguar nga sheshi. Sa i përket idesë se një turniri të madh unë jam që te jetë një organizim i tillë dhe përkrahu. Sa i përket kthimit për lapidarin në Qylagë, nuk e kemi ta paraparë në plan zhvillimore e njëjta edhe me stadiumin në Gadime.

Alban Salihu, tha se na e dimë që kompetence e kujtë është ujësjellësi, por a e keni ditë ju kur keni premtuar ne fushatë rregullimin e ujësjellësit. Ju duhet të ju bëni zgjidhje për ujin këtyre qytetareve.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha e kam kuptuar para se me hy në fushatë pasi që ne menaxhim jam mbi 20 vite, dhe çdo investim për ujësjellës ne e kemi bërë dhe do të financojmë prape, problemi është që nuk e menaxhojmë.

Fadil Spahiu, tha se unë thash që banorët janë të gatshëm që të lëshojnë pronën që aty të asfaltohet rruga.

Egzona Bytyqi, tha se çdo pyetje që ne e ngrisim në kuvend është e rëndësishë se veçante, dhe çështja e telefonive mobile është shqetësuese për banorët e asaj pjese.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se edhe dezinfektimiedhe dezisektimi edhe deratizimi janë të nevojshme për shesh, nuk ka rendësi se cilin term e përdorim. Pasi që është shumë i nevojshëm të bëhet.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, sa i përket pagesave i ka dërguar zyra e personelit dhe jemi në pritje. Sa i përket pëlqimit për prona private, nëse ata e bëjnë ne do t'i asfaltojmë ato.

Arsim Jashari, tha se kompania që është për mirëmbajtjen e fshatrave a ka mundësi që të bëjë pastrimin e pronave publike në fshatra pasi që janë në gjendje shumë të keqe, janë për shkak të rritjes së barishteve e vozitja e veturave nganjëherë po behët e vështir për shkak të këtyre.

Alban Salihu, tha se te shpronësimet të pronat private duhet me bërë një zgjidhje, dhe të përfundohen rrugët apo trotualet e jo për shkak të një individi të mbetet pa u përfunduar disa projekte.

Besiana Syla, tha se nëse nuk ka buxhet te mjaftueshëm komuna për dezisektim për qytetaret të paktën për emergjence do të ishte mire me pas.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, kemi kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve, është kontrate 3 vjeçare ku ajo e ka edhe sanimin e rrugëve e cila nuk po mundet me i përfshi të gjitha. Ne emergjence ka pas problem me mushkonja por jemi ka fundi i sezonës por ne jemi munduar aty ku kemi pas mundësi ta bëjmë atë.

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi në votim rendi i ditës i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 20 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 26 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 20-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Syla , tha se sa i përket Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023, e 4-ta herë është qe po jap vërejtje se ky raport nuk është alokim i mjeteve, pasi qe mjetet nuk janë të disponoheshme, pasi qe është buxhet vetëm i aprovuar dhe nuk po ju kuptoj se a nuk po dini me bo dallimin apo nuk po dini me kuptuar. Ne vetëm një pjese te buxhetit mund ta llogarisim si buxhet i alokuar e jo të gjithë shumën. Komuna e Lipjanit ka hyrë ne obligim pa zotim të mjeteve ne disa projekte.

Lulzim Rrustemi, tha se Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023, shumë pak kemi të shpenzuar dhe ky shpenzim tregon një pa përgjegjësi të madhe te ekzekutivit. Sipas fondeve burimore, kemi shpenzim te vogël po ashtu edhe te garanti qeveritar. Njëjtë është gjendja edhe te hyrat e bartura. Te buxheti sipas kategorive ekonomike edhe aty është shpenzim i vogël, njëjtë është edhe te subvencionet dhe transferet. Buxheti sipas te hyrave vetanake shpenzim tepër i vogël. Te buxheti nga donatoret e kemi zero. Te Infrastruktura publike kemi shume mjete pa shfrytëzuar, njëjtë e kemi edhe te shërbimet publike dhe te bujqësia dhe dektoratet tjera. Te shërbimet rezidencial kemi shumë mjete pa shfrytëzuar. Te investimet kapitale shpenzimi zero. Mbi 150 projekte janë me shpenzim ende zero, e të cilat ende nuk kane filluar punimet ne teren. Tatimi në prone kemi rritje për shkak të rritjes se çmimit të ri nga qeveria. Kemi një rritje të mire te lejet ndërtimorë po ashtu. Shqetësuese mbeten shpenzimet e derivateve dhe pagesat individuale.

Albiona Tasholli, tha se sa i përket Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023, po shihet që kemi një buxhet të shpenzuar mirë dhe kemi një rritje prej 4% të shpenzimeve dhe kjo tregon përkushtimin e ekzekutivit për ti përmbushur nevojat e qytetarëve.

Alban Salihu, tha se efikasiteti i ekzekutivit shihet te investimet kapitale, pasi që projektet janë, nevojat janë atëherë këtu duhet të punohet. Me sa po shihet edhe këtë vit është buxheti i shpenzuar pak dhe i dobët. Dhe po shihet që ka ngritje te investimet kapitale pasi që drejtoret duhet të punojnë me shume pasi qe kjo është keq.

Armend Graqevci, tha nëse e shohim raportin kemi një ngritje dhe një shpenzim shumë të kënaqshëm. Ekziston edhe 6 mujori i dytë edhe aty mund të ndryshohet raporti dhe përmirësohet.

Latif Ramadani, tha se ne kemi paraqitur një pasqyre të sakte se çka ka ndodh brena një viti. Unë e di shume mirë çka është i alokuar dhe çka është i miratuar. Ju thash këtu e keni një raport real. Pagesat individuale janë që janë berë nga

subvencionet dhe mund ti shihni kur të doni vetëm e bëni një kërkesë. Një pjese e projekteve kanë filluar dhe do ta ngrit përqindjen te investimet kapitale. Komuna e Lipjanit nuk ka bërë asnjë pagese pa zotim te mjeteve dhe pa i pas në dispozicion.

Besiana Syla, tha se te Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2023. dallimi qe e kam bërë unë mes buxhetit te alokuar dhe ati te aprovuar është se buxheti i alokuar është i disponoheshim për shpenzim, e ju nuk i keni këtë mjet për atë është i alokuar. Këtë vërejtje e kam dhënë qe disa herë. Kenë projekte që keni hy pa zotim siç është rruga Gjilan - Gadime dhe këto gabime duhet të përmirësohen.

Alban Salihu, unë nuk pata vërejtje te përpilimi i raportit, kritika jem është që shpenzimet kapitale duhet te përmirësohen.

Latif Ramadani, tha se asnjë investim nuk është kryer pa zotim të mjeteve në komunën e Lipjanit. Sa i përket investimeve kapitale do të ketë një përqindje të ngritur.

Besiana Syla, tha se komuna e Lipjanit ka hyr pa zotim të mjeteve në rrugën Gjilan - Gadime

Latif Ramadani, tha se asnjë projekt nuk është kryer pa zotim, në komune e Lipjanit

Me që diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën ne vijim

III

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, auditor i brëmshëm , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Shajdiqe Dragaqina, tha se raporti i auditimit tregon punën jo të mirë të kryetarit dhe ekzekutivit të komunës së Lipjanit, ku nga 10 rekomandime të ndalura 6 prej tyre janë të përsëritura, që e dëshmon qe ekzekutivi ka vazhduar te punoj në kundërshtim me rregulloren ne fuqi. Gjetja e parë e auditorit është ajo që e kemi ngrit edhe na si opozitë për konkurset në sektorin publik për mos përzgjedhje të kandidateve meritore.

E dyta shpallja publike për OJQ të, po ashtu edhe kostot shtesë për vendimet gjyqësore. Dhe ajo më skandalozja është pranimi i faturave vazhdon të bëhet para krijimit të urdhër blerjes. Dhe këto janë shumë shqetësuese për komunën tonë.

Arsim Jashari, tha se raporti i auditimit i nevojës së jashtëzakonshme, ne si opozitë i kemi dhënë të njëjtat rekomandime të cilat i ka gjet auditori siç janë konkurset, bursat për studentë dhe disa rekomandime tjera. E sidomos këtë për bursa për studentë që studiojnë jashtë vendit e të cilët kane mbet pa burse. Edhe te konkurset respektoni rregulloren, u kisha lut që këto rekomandime t'i merrni për bazë dhe t'i përmirësoni po ashtu edhe rekomandimet e opozitës merrni për bazë se janë për të mirën e qytetarëve.

Gazmend Qerkini, tha se ne si grup i LDK-së, mendojmë që opinionin i pa modifikuar është raporti më i mirë i mundshëm që ipet nga organizata buxhetore. Komuna e Lipjanit që disa vite ka këtë opinion të mirë, dhe uroj që edhe vitet tjera të ketë një raport të mirë. Pres që aty ka rekomandime të i përmirësojmë dhe të kemi një raport edhe më të mirë.

Armend Grajqevci, tha se një opinion i auditimit ka marrë një notë të lartë komuna e Lipjanit në nivel vendi dhe kjo me automatizëm e bënë komunën tonë konkurrentë për fitimin e garantëve të ardhshme si për auditim, performancë, buxhet apo edhe ndonjë garant tjetër.

Besiana Sylja, tha siç po shihet nga opinionin ka një pamje të drejtë, por kjo nuk do të thotë opinionin i pa modifikuar se çdo gjë ka qenë në rregull. Kur dihet se auditimi kryhet me anë mostrave. Janë 10 rekomandime prej tyre 6 të përsëritura dhe është shqetësuese se rekomandimet nuk janë marrë parasysh nga komuna e Lipjanit.

Lulzim Rustemi, tha se opinionin i pa modifikuar është një rezultat i mirë, dhe kjo është për të lavdëruar. Te gjetjet në disa mostra, unë do të ndalem në 3 prej tyre, e para te konkurset kjo është skandaloze, me ju marr dikunja 10 pike dhe me ju qitë dikujt tjetër dhe për këtë duhet dikush më dhënë përgjegjësi. E dyta, kriteret për ndarjen e bursave, ku 9 studentë që studiojnë jashtë shtetit kane mbet pa burse edhe kjo shqetësuese. E treta, plani vjetor për mbështetjen e OJQ-ve, duhet të ketë një plan e jo çdo herë të kemi të njëjtën. Dhe shqetësuese mbetet edhe endet përmbarimorë..

Alban Salihu, tha se gjetjet e përsëritura mos me u përmirësuar që sa kohe e të cilat i kemi ngritur ne si opozite që sa kohe dhe me këtë po shihet që nuk ka pas vullnet për përmirësim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha unë jam i kënaqur me raportin e aludimit. Rekomandimet të cilat janë dhënë, me shumë janë administrative. Na e kemi shqyrtuar këtë raport dhe i kemi dhënë rekomandimet tona, të cilat do t'i keni pas kësaj pike në rend dite të cilat e keni marr raportin me kohë.

Arsim Jashari, tha se në grupin PDK-së, e vlerësojmë lartë raportin e auditimit, e dyta këto rekomandime edhe ne i kemi dhënë më herët, e dimë që është qeshje administrative rekomandimet po për shkak të atyre qeshjeve administrative kanë mbetur studentet pa bursa por edhe punëtorët pa u pranuar.

Imri Ahmeti kryetar i komunës tha se, ekzekutivi është zbatues i asaj rregullore e dyta, e është riproceduar dhe është riformuluar ajo rregullore. Dhe ata studentë janë ndihmuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në piken në vijim

IV

Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2022, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Safet Krasniqit, auditor i mbrëmshëm, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua në piken në vijim.

Besjana Sylja tha se plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit paraqet sfida, ku kemi vazhdimisht rritje dhe jo rrënjë, ku të tatimi kemi rritje. Ku shumica e rekomandimeve kanë mbetur vetëm në letër nuk janë zbatuar.

V

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "PASTRIMI"SH.A.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se në këtë propozim vendim dhe kërkesë specifikohet për 581 familje, a është e sakte lista, kërkohet që të shpërndahen mjetet nuk e digjmë për cilat mjete është fjala. Dhe si do të mbulohet këto mjete. Ne si grup jemi që e gjithë lista në mënyrë proporcionale të mbulohet e gjitha. Ne si grup i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Fadil Spahiu, tha se propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për KRM "Pastrimi" SH.AMe që ky Propozim Vendim ka për qëllim ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 25.000 eurove për subvencionimin e familjeve në asistencë sociale të Komunës së Lipjanit për pagesën e borgjëve përkatësisht kryerjen e pjesëritshme të obligimeve të grumbulluara deri me datën 31.10.2022, që familjet në asistencë kanë ndaj Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" për ofrimin e shërbimeve për marrjen e mbeturinave sipas kërkesës së Kompanisë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi", e mbështes këtë Propozim Vendim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se kompania Pastrimi e ka ndërtuar një listë të borxheve që e kanë, Por ne kemi kërkuar nga QPS-ja, listën e rasteve që duhet me i paguar mbeturinat pasi që ne nuk i dimë këto. Na do ti paguajmë mbeturinat për këto raste deri në dhjetor të vitit 2022

Gazmend Qerkini, tha se një veprim human por lehtësimin e kësaj kategorie gjithashtu e një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e ambientit. Kam një pyetje javën e kaluar dy makina për pastrim, komunës por komuna si duket ja ka dhuruar kompanisë pastrimi çka do të ndodh me ato makina.

Arsim Jashari, tha se unë edhe në KPF kam thënë që drejtoria duhet me pas një liste se kunda duhet me i ndihmuar. Ne si grup e mbështesin këtë iniciativë dhe çdo herë do t'i mbështesim rastet sociale. A do të vazhdojnë të mbështeten këto rastet edhe për vitet e ardhshme dhe çka do të ndodh me vitet paraprake.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se a është fjala për pagesën për vitet e ardhshme. Kompani në fjalë e ka bërë një kërkesë me shumë gabime gjuhësore dhe jo serioze, duhet t'i ipet vërejtje kësaj kompanie.

Alban Salihu, tha se sa here ka mundësi që komune të ju ndihmoj rasteve sociale është e mirë . E dyta është një kërkesë me gabime drejtshkrimore shumë pa kuptueshme.

Albiona Tasholli, tha se iniciativa për me ju ndihmua rasteve te tilla është për tu lavdëruar dhe ne si grup i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, një kërkesë që ka ardh nga arkiva dhe ne nuk mund te ju kthejmë kërkesa palëve pasi që kane gabime drejtshkrimore. Borxhet do të paguhet deri ne dhjetor te vitit 2022. Jemi duke bërë përpjeke që edhe vitet në vazhdim me i paguar, por këtë duhet ta akomodojmë në kuadër te buxhetit. Dy auto vetura auto fshesat ia kemi huazuar kompanisë Pastrimi, po ashtu do të rritet numri i shportave në qytetin e Lipjanit edhe këto grant i fituar.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13:00.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi